



## Shtojca A

### Protokolli për Vlerësimin e Varfërisë

#### Përmbajtja

PJESA 1	QËLLIMI DHE PËRKUFIZIMET .....	1
PJESA 2	PARIMET E VLERËSIMIT TË VARFËRISË.....	2
PJESA 3	LLOGARITJA E KONTRIBUTIT .....	2
PJESA 4	PASURITË E PËRFSHIRA NË MJETET E DISPONUESHME .....	3
PJESA 5	PASURITË E PËRJASHTUARA NGA MJETET E DISPONUESHME.....	3
PJESA 6	TË ARDHURAT E PËRFSHIRA NË MJETET E DISPONUESHME .....	5
PJESA 7	TË ARDHURAT QË PËRJASHTOHEN NGA MJETET E DISPONUESHME.....	5
PJESA 8	DETYRIMET QË ZBRITEN NGA MJETET E DISPONUESHME.....	6
PJESA 9	FORMULA PËR LLOGARITJEN E KAPITALIT TË ZOTËRUAR NË SHTËPINË KRYESORE (FAMILJARE).....	6
PJESA 10	FORMULA PËR LLOGARITJEN E SHPENZIMEVE TË PËRAFËRTA TË JETESËS.....	7
PJESA 11	KONTRIBUTI .....	7

#### Pjesa 1 Qëllimi dhe përkufizimet

- Ky Protokolli për Vlerësimin e Varfërisë ('Protokolli') përcakton me hollësi faktorët që merr parasysh nga Administratori për përcaktimin e shkallës së varfërisë së një të dyshuari ose të akuzuari në bazë të rregullës 8 dhe rregullës 9 të Rregullores së Ndhmës Juridike ('RRNJ').
- Termet e përdorura në këtë Protokolli bazohen në rregullën 2 të RRNJ-së. Krahas tyre përdoret edhe përkufizimi i mëposhtëm:

Pasuri mjetet neto që zotëron i dyshuari apo i akuzuari, dhe/ose bashkëshortja/bashkëshorti dhe anëtarët e bashkësisë familjare, dhe/ose cildo person tjetër i lidhur financiarisht me të.

## Pjesa 2 Parimet e vlerësimit të varfërisë

- Në përputhje me rregullën 8 të RRNJ-së, për vlerësimin e varfërisë (të plotë apo të pjesshme), Administratori:
  - vlerëson mjetet të cilat disponon i dyshuari ose i akuzuari;
  - nga mjetet e disponueshme zbrit shpenzimet e përafërta të jetesës të të dyshuarit ose të akuzuarit.Shuma që mbetet përfaqëson shumën e disponueshme për kontributin e të dyshuarit ose të akuzuarit për pagimin e përfaqësimit juridik të vet para Dhomave të Specializuara.
- Në bazë të rregullës 8 të RRNJ-së, vlerësimi i mjeteve të disponueshme të të dyshuarit ose të akuzuarit, i shpenzimeve të përafërta të jetesës dhe i mjeteve që disponon i dyshuari ose i akuzuari për pagimin e përfaqësimit juridik para Dhomave të Specializuara, kryhet në përputhje me këtë Protokoll, përmes verifikimit të mjeteve financiare të të dyshuarit ose të akuzuarit, të bashkëshortit/bashkëshortes, anëtarëve të bashkësisë së tij familjare dhe/ose të cilitdo personi tjetër të lidhur financiarisht me të.
- Për kryerjen e këtij vlerësimi, mjetet që përkohësisht nuk janë të disponueshme ose që nuk janë lirisht të disponueshme, konsiderohen mjete të padisponueshme.
- Gjatë vlerësimit të shkallës së varfërisë merren parasysh të dhënat statistikore të organizatave shtetërore ose ndërkombëtare të statistikave që veprojnë në shtetin e vendbanimit dhe/ose në shtetin e aktivitetit financiar të të dyshuarit ose të akuzuarit, për aq sa këto të dhëna janë të disponueshme dhe të përditësuara.
- Për kryerjen e këtij vlerësimi, ndihmat financiare në bazë të Ligjit Nr. 05/L-054 të Kosovës, si edhe çfarëdo kontributi tjetër për përfaqësimin juridik të të dyshuarit ose të akuzuarit, ose për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me paraburgimin, nëse ka, nuk konsiderohen mjete të disponueshme. Në rast se i dyshuari ose i akuzuari plotëson kushtet për të marrë ose ka marrë ndihma të tilla, ai/ajo nuk konsiderohet plotësisht i varfër dhe ndihma të tilla financiare trajtohen si kontribut për mbulimin e shpenzimeve të përfaqësimit juridik të të dyshuarit ose të akuzuarit.

## Pjesa 3 Llogaritja e kontributit

- Kontributi i të dyshuarit ose të akuzuarit në mbulimin e shpenzimeve të përfaqësimit të vet juridik, siç përcaktohet në rregullën 8(2) të RRNJ-së dhe **Error! Reference source not found.**.1.a të këtij Protokollit, llogaritet si vijon:

$$DM - ELE = C$$

- Ku:
  - DM përfaqëson mjetet e disponueshme të të dyshuarit ose të akuzuarit, të llogaritura sipas pjesëve 4 deri në 8 të këtij Protokollit;
  - ELE përfaqëson shpenzimet e përafërta të jetesës të të dyshuarit ose të akuzuarit dhe/ose bashkëshortes/bashkëshortit dhe anëtarëve të bashkësisë familjare, dhe/ose cilitdo personi tjetër të lidhur financiarisht me të, llogaritur në **Error! Reference source not found.** të këtij Protokollit;

**Dhomat e Specializuara të Kosovës**  
**Shtojca A e Rregullores së Ndihmës Juridike**  
**Protokolli për Vlerësimin e Varfërisë**  
KSC-BD-25-Rev1

- c. C përfaqëson mjetet që disponon i dyshuari ose i akuzuari për të kontribuar në pagimin e përfaqësimit të vet juridik para Dhomave të Specializuara, çka është e barabartë me kontributin që do të paguajë i dyshuari ose i akuzuari për përfaqësimin e vet juridik.

#### **Pjesa 4 Pasuritë e përfshira në mjetet e disponueshme**

Pasuritë që përfshihen në mjetet e disponueshme përcaktuar në Pjesa 2.1.a të këtij Protokolli, janë:

- a. kapitali i zotëruar në shtëpinë kryesore (familjare) që tejkalon nevojat e arsyeshme të të dyshuarit ose të akuzuarit dhe/ose bashkëshortes/bashkëshortit dhe anëtarëve të bashkësisë familjare, dhe/ose cilitdo personi tjetër të lidhur financiarisht me të. Shtëpia kryesore (familjare) i tejkalon nevojat e arsyeshme në qoftë se është me vlerë më të madhe në krahasim me shtëpitë (familjare) mesatare në rajonin ku ajo ndodhet. Formula përkatëse e llogaritjes gjendet në Pjesa 9 të këtij Protokolli;
- b. kapitali i zotëruar në orendi dhe pajisje në shtëpinë kryesore (familjare), të cilat janë pronë e të dyshuarit ose të akuzuarit dhe/ose bashkëshortes/bashkëshortit dhe anëtarëve të bashkësisë familjare, dhe/ose cilitdo personi tjetër të lidhur financiarisht me të, që i tejkalon nevojat e arsyeshme të këtyre personave. Orenditë dhe pajisjet në shtëpinë kryesore (familjare) i tejkalojnë nevojat e arsyeshme në qoftë se janë sende luksoze me vlerë të jashtëzakonshme, duke përfshirë, ndër të tjera, koleksione të artit, koleksione të antikave;
- c. kapitali i zotëruar në automjetin/automjetet kryesore (familjare) që tejkalon nevojat e arsyeshme të të dyshuarit ose të akuzuarit dhe/ose bashkëshortes/bashkëshortit dhe anëtarëve të bashkësisë familjare, dhe/ose cilitdo personi tjetër të lidhur financiarisht me të. Automjeti/automjetet kryesore (familjare) tejkalojnë nevojat e arsyeshme në qoftë se vlera e gjithsejtë e tyre është më e madhe se vlera e një automjeti të ri mesatar për udhëtarë në shtetin e vendbanimit të dyshuarit ose të akuzuarit, ose të familjes së tyre, sipas rastit;
- d. kapitali i zotëruar në aksione, letra me vlerë, ose llogari bankare që janë në emër të të dyshuarit ose të akuzuarit, dhe/ose bashkëshortes/bashkëshortit dhe anëtarëve të bashkësisë familjare, dhe/ose cilitdo personi tjetër të lidhur financiarisht me të;
- e. kapitali i zotëruar në çfarëdo prone tjetër të të dyshuarit ose të akuzuarit dhe/ose të bashkëshortes/bashkëshortit dhe anëtarëve të bashkësisë familjare, dhe/ose të cilitdo personi tjetër të lidhur financiarisht me të, që nuk renditet në Pjesa 5 të këtij Protokolli, duke përfshirë, ndër të tjera, pasuri të tjera të paluajtshme, tokë, banesa, sende luksoze personale si orë, stoli, koleksione armësh, automjete të tjera si motorë, biçikleta, anije, kamionë, dhe kompani biznesi;
- f. çfarëdo pasurie e mëparshme e të dyshuarit ose të akuzuarit dhe/ose bashkëshortes/bashkëshortit dhe anëtarëve të bashkësisë familjare, dhe/ose e cilitdo personi tjetër të lidhur financiarisht me të, që i është caktuar ose transferuar një personi tjetër me qëllim fshehjen e pasurisë;
- g. çfarëdo pasurish të tjera që logjikisht pritet të jenë të disponueshme për personin që pretendon se është i varfër.

## **Pjesa 5 Pasuritë e përjashtuara nga mjetet e disponueshme**

1. Në mjetet dhe pasuritë që përjashtohen nga mjetet e disponueshme përmendur në Pjesa 2.1.a të këtij Protokolli bëjnë pjesë:
  - a. kapitali i zotëruar në shtëpinë kryesore (familjare) në masën e nevojshme dhe të mjaftueshme për plotësimin e nevojave të të dyshuarit ose të akuzuarit dhe/ose të bashkëshortes/bashkëshortit dhe anëtarëve të bashkësisë familjare, dhe/ose cilitdo personi tjetër të lidhur financiarisht me të;
  - b. kapitali i zotëruar në orenditë dhe pajisjet në shtëpinë kryesore (familjare), të cilat janë pronë e të dyshuarit ose të akuzuarit, dhe/ose bashkëshortes/bashkëshortit dhe anëtarëve të bashkësisë familjare, dhe/ose cilitdo personi tjetër të lidhur financiarisht me të, për aq sa orendi dhe pajisje të tilla janë të nevojshme dhe të mjaftueshme për plotësimin e nevojave të këtyre personave;
  - c. kapitali i zotëruar në automjetin kryesor (familjar) për aq sa mjafton dhe është i nevojshëm në për plotësimin e nevojave të të dyshuarit ose të akuzuarit dhe/ose të bashkëshortes/bashkëshortit dhe anëtarëve të bashkësisë familjare, dhe/ose cilitdo personi tjetër të lidhur financiarisht me të;
  - d. kapitali i zotëruar nga bashkëshortja/bashkëshorti i të dyshuarit ose të akuzuarit, që nuk përbën pronë martesore. Administratori përcakton nëse një pronë e tillë është pronë martesore në bazë të kriterëve për pronë martesore të shtetit ku i dyshuari ose i akuzuari dhe bashkëshortja/bashkëshorti janë martuar apo banojnë, me përjashtim kur ofrohen prova që vërtetojnë të kundërtën;
  - e. kapitali në mjetet e punës të zotëruara nga i dyshuari ose i akuzuari dhe/ose bashkëshortja/bashkëshorti dhe anëtarët e bashkësisë familjare, dhe/ose cilitdo person tjetër i lidhur financiarisht me të, të cilat janë logjistikisht të nevojshme për jetesën e këtyre personave;
  - f. mjete të personit të lidhur financiarisht me të dyshuarin ose të akuzuarin që duhet të përjashtohen sipas Pjesa 5.3 të këtij Protokolli;
  - g. ndihmat financiare që i janë paguar, ose për të cilat i dyshuari ose i akuzuari i plotëson kushtet për t'i marrë sipas Ligjit Nr. 05/L-054 të Kosovës, mbrojtësit të caktuar apo të dyshuarit ose të akuzuarit, dhe/ose bashkëshortes/bashkëshortit dhe anëtarëve të bashkësisë familjare, dhe/ose cilitdo personi tjetër të lidhur financiarisht me të;
  - h. çfarëdo kontributesh për përfaqësimin juridik të të dyshuarit ose të akuzuarit, të ndryshme nga ato të përmendura në Pjesa 5.1.g të këtij Protokolli, që i paguhen mbrojtësit të caktuar apo të dyshuarit ose të akuzuarit dhe/ose bashkëshortes/bashkëshortit dhe anëtarëve të bashkësisë familjare, dhe/ose cilitdo personi tjetër të lidhur financiarisht me të;
2. Në mjete të disponueshme sipas Pjesa 2.3 të këtij Protokolli nuk përfshihen pasuritë ose mjetet e të dyshuarit ose të akuzuarit dhe/ose bashkëshortes/bashkëshortit dhe anëtarëve të bashkësisë familjare, dhe/ose cilitdo personi tjetër të lidhur financiarisht me të, që janë të ngrira ose për çfarëdo arsye tjetër përkohësisht të padisponueshme ose jo lirisht të disponueshme. Në qoftë se pasuri apo mjete të tilla vihen në dispozicion dhe bëhen lirisht të disponueshme në çdo kohë deri në pesë (5) vjet pas pagesës së fundit të honorarit të ndihmës juridike, kjo mund të përbëjë ndryshim thelbësor të rrethanave dhe Administratori njoftohet për sa më sipër pa vonesë të paarsyeshme, në përputhje me rregullën 9(6) të RRNJ-së. Administratori mund të rimarrë pjesën e

**Dhomat e Specializuara të Kosovës**  
**Shtojca A e Rregullores së Ndhmës Juridike**  
**Protokolli për Vlerësimin e Varfërisë**  
KSC-BD-25-Rev1

honorarit të ndihmës juridike prej atyre mjeteve që i dyshuari ose i akuzuari është në gjendje të kontribuojë, në përputhje me vendimin përfundimtar për mjetet e personit.

3. Mjetet e cilitdo personi tjetër të lidhur financiarisht me të dyshuarin ose të akuzuarin përjashtohen nga mjetet e disponueshme, në qoftë se vërtetohet se:
  - a. të ardhurat dhe/ose pasuritë e personit të lidhur financiarisht me të dyshuarin ose të akuzuarin nuk janë të disponueshme për përdorim ose përfitim nga i dyshuari ose i akuzuari;
  - b. i dyshuari ose i akuzuari nuk ka qasje në këto të ardhura apo pasuri.
4. Ndhimat financiare dhe kontributet përmendur në Pjesa 5.1.g dhe 5.1.h të këtij Protokollit trajtohen në përputhje me Pjesa 2.5 të këtij Protokollit.
5. Në raste të jashtëzakonshme dhe në veçanti në qoftë se varfëria vlerësohet në kuadër të përfaqësimit juridik afatshkurtër, Administratori mund të vendosë të përjashtojë nga mjetet e disponueshme ato mjete për të cilat, në ato rrethana, do të duhej të ndërmerreshin hapa të jashtëzakonshëm për t'i bërë mjete të disponueshme.

## **Pjesa 6 Të ardhurat e përfshira në mjetet e disponueshme**

1. Në vlerësimin e mjeteve të disponueshme të të dyshuarit ose të akuzuarit sipas Pjesa 2.1.a të këtij Protokollit, Administratori konsideron si mjete të disponueshme të të dyshuarit ose të akuzuarit dhe/ose bashkëshortes/bashkëshortit dhe anëtarëve të bashkësisë familjare, dhe/ose cilitdo personi tjetër të lidhur financiarisht me të:
  - a. Pagat, pagesat me bazë ditore ose orare, dhe komisionet;
  - b. të ardhurat nga biznesi pas zbritjes së shpenzimeve të arsyeshme;
  - c. të ardhurat nga investimet;
  - d. pensionet shtetërore;
  - e. kompensimet e tjera shtetërore të ndryshme nga pagesat e ndihmës sociale;
  - f. pagesat e kompensimit të punëtorëve;
  - g. pagesat e ushqimisë, ndarjes së bashkëshortëve dhe mbajtjes financiare që i takojnë të dyshuarit ose të akuzuarit;
  - h. pagesat e rregullta që personi i merr nga skemat vjetore të pensionit ose të sigurimeve;
  - i. pagesat e rregullta që personi i merr nga hipoteka, kontrata për shitje ose kontrata për hua;
  - j. të ardhura të tjera të rregullta që nuk përjashtohen në Pjesa 7 të këtij Protokollit.
2. Administratori përcakton mjetet e disponueshme për fazën përkatëse të procesit, të llogaritur që prej momentit kur i dyshuari ose i akuzuari ka dorëzuar Formularin e Deklarimit të Mjeteve Financiare sikurse i është kërkuar dhe për kohëzgjatjen e përllogaritur të fazës së procedurave në të cilën të dyshuarit ose të akuzuarit do t'i duhet përfaqësim juridik para Dhomave të Specializuara.

## **Pjesa 7 Të ardhurat që përjashtohen nga mjetet e disponueshme**

Nga të ardhurat e të dyshuarit ose të akuzuarit dhe/ose bashkëshortes/bashkëshortit dhe anëtarëve të bashkësisë familjare, dhe/ose cilitdo personi tjetër të lidhur financiarisht me të, në mjete të disponueshme të të dyshuarit ose të akuzuarit sipas Pjesa 2.1.a të këtij Protokollit nuk përfshihen:

- a. pagesat e ndihmës sociale nga shteti;

- b. të ardhurat e fëmijës ose fëmijëve të të dyshuarit ose të akuzuarit;
- c. pagesat e ushqimisë, ndarjes së bashkëshortëve dhe mbajtjes financiare që i takojnë bashkëshortit/bashkëshortes së të dyshuarit ose të akuzuarit dhe/ose anëtarëve të bashkësisë së tij ose saj familjare dhe/ose cilitdo person tjetër të lidhur financiarisht me të.

## Pjesa 8 Detyrimet që zbriten nga mjetet e disponueshme

Nga mjetet e disponueshme të të dyshuarit ose të akuzuarit zbriten detyrimet e mëposhtme të të dyshuarit ose të akuzuarit dhe/ose bashkëshortes/bashkëshortit dhe anëtarëve të bashkësisë familjare të tij, dhe/ose cilitdo personi tjetër të lidhur financiarisht me të:

- a. borxhet që janë ose personale, ose të njësisë së biznesit të zotëruar nga i dyshuari ose i akuzuari;
- b. hua nga banka ose subjekte të tjera financiare apo persona privatë, vërtetësia e të cilave mund të verifikohet;
- c. kapital i përdorur për financimin e blerjes së pasurive krahas shtëpisë kryesore (familjare).

## Pjesa 9 Formula për llogaritjen e kapitalit të zotëruar në shtëpinë kryesore (familjare)

Formula për llogaritjen e masës në të cilën vlera e kapitalit të zotëruar në shtëpinë kryesore (familjare) të të dyshuarit ose të akuzuarit tejkalon nevojat e të dyshuarit ose të akuzuarit dhe/ose bashkëshortes/bashkëshortit dhe anëtarëve të bashkësisë familjare, dhe/ose cilitdo personi tjetër të lidhur financiarisht me të dhe mund të konsiderohet pjesë e mjeteve të disponueshme, është si vijon:

$$((V/LS) \times LSE) - EN = E$$

1. Ku:

- a. V përfaqëson vlerën e shtëpisë kryesore (familjare);
- b. LS përfaqëson hapësirën e banimit në metra katrorë në shtëpinë kryesore familjare;
- c. LSE përfaqëson hapësirën e banimit në shtëpinë kryesore (familjare) që tejkalon hapësirën mesatare të jetesës për numrin e personave që banojnë rregullisht në shtëpinë kryesore (familjare) në shtetin ku ndodhet shtëpia. Kjo shifër përcaktohet në përputhje me të dhënat zyrtare statistikore më të fundit që publikon qeveria e shtetit të vendbanimit ose një organizatë e njohur ndërkombëtare. Për llogaritjen e LSE përdoret formula e mëposhtme:

$$LS - (ALS \times M) = LSE$$

Ku:

- d. ALS përfaqëson numrin mesatar të metrave katrorë të hapësirës së banimit për frymë në shtetin ku ndodhet shtëpia kryesore (familjare), bazuar në të dhënat e disponueshme dhe më të fundit zyrtare statistikore;
- e. M përfaqëson numrin e personave që banojnë rregullisht në shtëpinë kryesore (familjare), duke përfshirë të dyshuarin ose të akuzuarin dhe/ose bashkëshorten/bashkëshortin dhe anëtarët e bashkësisë familjare, dhe/ose cilitdo person tjetër të lidhur financiarisht me të;
- f. EN përfaqëson çdo detyrim hipotekar të regjistruar kundrejt shtëpisë kryesore (familjare);

**Dhomat e Specializuara të Kosovës**  
**Shtojca A e Rregullores së Ndhmës Juridike**  
**Protokolli për Vlerësimin e Varfërisë**  
KSC-BD-25-Rev1

- g. E përfaqëson vlerën e shtëpisë kryesore (familjare) që tejkalon nevojat e arsyeshme të të dyshuarit ose të akuzuarit dhe/ose bashkëshortes/bashkëshortit dhe anëtarëve të bashkësisë familjare, dhe/ose cilitdo personi tjetër të lidhur financiarisht me të. Në qoftë se kjo shumë është më e madhe se zero, ajo përfshihet në mjetet e disponueshme të të dyshuarit ose akuzuarit, në përputhje me Rregulloren për Ndhmën Juridike.

## **Pjesa 10      Formula për llogaritjen e shpenzimeve të përafërta të jetesës**

1. Formula për llogaritjen e shpenzimeve të përafërta të jetesës sipas rregullës 8(2) të RRNJ-së dhe Pjesa 2.1.b të këtij Protokolli është si vijon:

$$(((AE/AH) \times (M+D)) + EE) \times T = ELE$$

2. Ku:

- a. AE përfaqëson shpenzimet mesatare mujore për një bashkësi familjare mesatare sipas të dhënave më të fundit statistikore zyrtare të disponueshme të publikuara nga qeveria e shtetit të vendbanimit ose një organizatë e njohur ndërkombëtare. Këto shpenzime përfshijnë strehimin dhe shpenzimet e jetesës;
- b. AH përfaqëson numrin mesatar të personave që jetojnë në një bashkësi familjare në shtetin e vendbanimit të të dyshuarit ose akuzuarit;
- c. M përfaqëson numrin e njerëzve që banojnë rregullisht në shtëpinë kryesore familjare, duke përfshirë të dyshuarin ose të akuzuarin dhe/ose bashkëshorten/bashkëshortin dhe anëtarët e bashkësisë familjare, dhe/ose cilitdo person tjetër të lidhur financiarisht me të;
- d. D përfaqëson personat të cilët janë në varësi financiare nga i dyshuari ose i akuzuari, të cilët nuk banojnë rregullisht në shtëpinë kryesore (familjare);
- e. EE përfaqëson shpenzimet mujore shtesë të jetesës, nëse ka, të të dyshuarit ose të akuzuarit dhe/ose bashkëshortes/bashkëshortit dhe anëtarëve të bashkësisë familjare, dhe/ose cilitdo personi tjetër të lidhur financiarisht me të. Shpenzime të tilla shtesë të jetesës janë shpenzime të veçanta për këta persona dhe rrjedhimisht nuk parashihen në treguesin AE në Pjesa 10.2.a të këtij Protokolli. Në shpenzimet mujore shtesë të jetesës bëjnë pjesë, ndër të tjera, tarifat e shkollimit dhe shpenzimet e shërbimit të veçantë mjekësor, pagesat e sigurimeve, shpenzimet e arsyeshme të udhëtimit të anëtarëve të bashkësisë familjare të të dyshuarit ose të akuzuarit për ta vizituar atë në paraburgim.
- f. T përfaqëson kohëzgjatjen e përafërt gjatë së cilës nevojitet ndihmë juridike;
- g. ELE përfaqëson shpenzimet e përafërta të jetesës të të dyshuarit ose të akuzuarit dhe/ose bashkëshortes/bashkëshortit dhe anëtarëve të bashkësisë familjare, dhe/ose cilitdo personi tjetër të lidhur financiarisht me të, gjatë asaj faze të procesit, të llogaritur që prej momentit kur i dyshuari ose i akuzuari ka dorëzuar Formularin e Deklarimit të Mjeteve Financiare sikurse i është kërkuar dhe për kohëzgjatjen e përlllogaritur të fazës së procesit në të cilën të dyshuarit ose të akuzuarit do t'i duhet përfaqësim juridik para Dhomave të Specializuara.

## Pjesa 11 Kontributi

1. Administratori mund të marrë vendim nëse kontributi i të dyshuarit ose të akuzuarit në mbulimin e shpenzimeve të përfaqësimit juridik, përcaktuar në rregullën të RRNJ-së, do t'i paguhet drejtpërsëdrejti mbrojtësit apo Dhomave të Specializuara. Në rastet kur i dyshuari ose i akuzuari merr ose plotëson kushtet për të marrë ndihmat ose kontributet e përmendura në Pjesa 5.1.g dhe 5.1.h të këtij Protokollit, në marrjen e vendimit në lidhje me kontributin, Administratori mban parasysh se kush është përfituesi i drejtpërdrejtë i këtyre ndihmave dhe kontributeve.
2. Administratori përcakton afatet dhe kështet e kontributit.

Hagë, Holandë  
22 shkurt 2024

\_\_\_\_\_  
Dr. Fidelma Donlon  
Administratore